

VEHBI  
SKËNDERI

8JH-1

565

*Mitri*

POEZI

253


V  
ide  
Spieldienst

*Redaktor*

PERIKLI JORGONI

Perikli

book



СРЕДА МОЛУСЕ - НАУКИ КРАСИТЕЛИ

## Poëzieto.

Welt der alten und neuen Welt  
Doch wenn sie jemal' im Lande sind,  
Qualen führen und wirken,  
So schlägt sie die glückliche Lieder.

Nicht nur hört man sie, sondern auch sie hören

### I. Poezitë e ditës

me tuis zj, o më dëgë, që du ier vël hënauen  
me dëgënd, jen la vël dëgënd,  
me tuis tuis, që dëgënd, dëgënd,  
me dëgënd, me dëgënd, dëgënd, dëgënd,  
me tuis tuis, tuis, tuis, tuis, tuis, tuis,

me abegënd, abegënd, abegënd, abegënd,  
me abegënd, abegënd, abegënd, abegënd,  
me abegënd, abegënd, abegënd, abegënd,

A. Leesells & d'Urs

## N X I T O J

Nxitoj, si një shtegtar, që rend e rend gjithnjë  
Posi veriu në pyll, që pylli nuk nxë;  
Që të fitoj një vit; të paktën një minutë.  
Se rruga është e gjatë dhe çapi është i shkurtë.

Nxitoj! Në këtë maratonë, pas shokëve mos mbe-  
rëdore, s'përdorë zemra, s'përdorë artem;  
e shaj urbanët shpesh, e zihem me vjetveten;  
Jo! s'dua kursesi dhe një qelizë të amë mpihet!

Nxitoj që të arrij, atë që zor arrihet:

me tingujt e me zërat, që skaj më skaj përhapen  
me fluturat sekonda, që ikin e nuk kapen,  
me retë nëpër qiell e një rrëke në baltë,  
me djemtë tërë shënd dhe vajzat supejashtë,  
me një kampion në vrap e një kampion në peshë,  
me lumin që vrapon e kërkënd s'di të presë,  
me njerëz të çdo moshe, që turren link me  
njerëzit,  
me zhurmat e kamjonve dhe lajmet e mëngjesit!

Nxitoj! Në këtë mot të madh, plot diellë dhe plot  
ndeshje,  
që dete e oqeane, fut në një kuti shkrepse,

## LOTIKI

ku hapet çdo mendim, me shpejtësi komete  
dhe po të flesh një dit, — një shekull prapa  
mbetesh!

Nxitoj!

— Avash! — klith një molusk e ngrin krejt  
dhe vrejnë kureshtarët, vetëtimthi, që të shohën,  
Jo! Po të vdes një dit, do vdes duke vrapuar,  
Që dhe si të kem i kur, të fluturojme kohën!  
Nxitoj..

— Një dit, — me shpejtësi komete  
dhe po të flesh një dit, — një shekull prapa  
mbetesh!

## N E F S H A T

Kur shkova përsëri në fshat,  
kujtova mos po më qortonin kumbullat,  
se kishin kohë që s'më kishin parë,  
por ato sa më njohën shtrinë krahët.

Kur shkova përsëri në fshat,  
mendova se mos krojet s"do më flisnin,  
se kishin kaq vite që më prisnin,  
por ata nisën këngën sa më panë.

Kur shkova përsëri në fshat,  
mendova mos më hiqnin pleqtë veshin,  
kurse ata (që ende s'kishin vdekur)  
me të më ndier zënë, nisën të buzëqeshin,  
duke përlotur sytë...  
Po u ngeli fjala si një gdhë në grykë.

Kur shkova përsëri në fshat,  
kujtova mos nuk do më njihnin rrugët,  
se rrugët, si lumenj, gjithnjë lëvizin;  
por kishin ngelur, tek i lashë, gurët  
që tërë ëndje po më prisnin mua...

## ТАХАТ

Dhe zemra desh më shkau, si top, prej duarve,  
sikur të mbante gjith' peshën e gurëve,  
e desh m'u ça nga malli i madh i rrugëve!

Далесија, када је било веома често  
да се у овим крајевима србите и албанци  
се сукобијали, да ће србија бити под контролом  
албанаца, а да ће албанци бити под контролом

србије, али и да ће србија бити под контролом  
турског царства, али и да ће албанци бити под контролом  
турског царства, али и да ће србија бити под контролом  
турског царства, али и да ће албанци бити под контролом

турског царства, али и да ће србија бити под контролом  
турског царства, али и да ће албанци бити под контролом  
турског царства, али и да ће србија бити под контролом  
турског царства, али и да ће албанци бити под контролом

## POEZI PËR TË THJESHTIN

Ne jemi shokë, dihet 'zjarrmëtar.  
Kjo miqësi s'ndërron për vit, si moda.  
Na ka përzhitur vapë dhe acar  
dhe e kemi ngrënë pluhurin me skoda.

Ndaj s'kam guxim të shkruaj sot për ty  
as dhe një rresht, që të kënaqet sedra.  
Ti do çuditeshe; C'ka me mua ky! —  
dhe bosh në çast do të të dukej zemra.

Se pa të keq ti pret bisedën shkurt,  
pa zbukurime, bile pak si thatë.  
Të nervozojnë frazat njëqind kut  
e çdo «sentencë» që bën dush në mjaltë.

Dhe një minutë nuk e duron dot  
atë që hedh në verë ujë.  
Ti ndihesh ngushtë! Ndien së thelli ndot  
nga çdo tellall, që trompat fryn për bujë!

МИЛЛЕГИТ ЗИ НЭР ТЕРӨН

Pa rri mbush minat, dhjété orë radhë  
në qetësi, pa humbur asnje çast.  
Ti, sikur lot, u vë fitilave zjarr  
dhe shkrepi i egér shfryñ vullkan gjer lart!

Veç një sekondë, minator, t'i s'rri  
kur nuk nxjerr tym dhe hesht kapsullë e shurdhët.  
Por ndodh në shkëmb gufon një tym i zi!  
Por ndodh papritur merr mandata udhët...

Ndaj qindra herë e shkruaj këtë vjershë  
dhe ajo që dua ngelet prapë larg.  
Ka bukuri të jesh në jetë i thjeshtë,  
por ec e fut të thjeshtin në një varg!

## P R I T J A

Po gdhijmë në kantier midis thëllimit,  
në hekurin e sondave duart ngjitur,  
duke kërcitur dhëmbët  
e duke pritur...

Por ç'është vallë ky vegim së largu  
dhe ç'mund të jetë, thoni ju, kjo pritje?  
Një siluetë nën pemët e një parku,  
tek na zhuritin faqet nga tronditja?

Acari fryn e vërshëllen me lumin!  
Ne rrahim mbi kallkan shuajt e këmbëve  
derisa ndiejmë dhembje  
dhe e flakim nga qerpiqët prapë gjumin.

Dhe presim.  
Dhe hedhim sytë shpesh nga Alpet.  
Dhe vërejmë qiellin,  
që me mundim sikur fillon të hapet...

Po. Presim diellin!

PRIJMA

Shih tek po qesh trimoshi mes shkëmbinjve, —  
si një shtegtar gazmor —  
dhe «mirëmëngjes!» na thotë.  
Ti mirëmëngjes, — i themi — më iqmiri shok  
në tokë,  
që askërkënd pa njatjetuar s'lë.

Dhe qeshim të kënaqur tok meitë.

## L È V I Z J E

Ndaloj aty ku kryqëzohen rrugët  
nga katër pika në drejtim të kundërt.

Frenon një skodë dhe më piklohet krejt këmisha,  
e shoqëron Sopoti plot me pisha!

Një targë me BC:  
ka grimca bore, përmbi xham, te dera.  
Ndofta ma kanë nisur shokët nga miniera.

Diçka e bukur dhe e këndshme kjo lëvizje  
veri dhe jug, perëndim e lindje.

Diçka e thjeshtë: erë mollë, erë çaj, erë naftë.  
Ka në të djersë, lule e baltë.

Ka në të vite copëzuar nëpër turne.  
Ka në të lodhje, gaz dhe çfarëdo zhurmë.

Ka në të vreshtë, fushë dhe Koman.  
Ka në të akull, zheg edhe tufan!

## G J Y S H I

Më erdhi gjyshi mbrëmë mysafir  
me Balon pas, hedhur mbi supe rraqet,  
mbështjellë kokën me peshqir,  
me mjekrën drizë, desh më çjerr në faqet.

Dhe plas, nëpër tapet, si me shaka opingat,  
gunën e dhirtë më vërvit në kokë,  
sa desh u thyen qelqurinat  
e këmbëkryq na shtrohet, shesh, në tokë.

Dhe pa më folur hiç, as keq, as mirë,  
çaktis në strall e zë një xhufkë eshkë,  
çibukun mbush me plot duhan të grirë,  
që tym gufon, si mjegulla në bjeshkë.

Baloja sakaq ia merr me gjumë,  
sikur s'qe në kuzhinë po diku në Pad.  
Gjyshi e mbështjell, si kalama, me gunë  
edhe më nge televizorin hap.

## SHI BEHARI

E tek po ndjek një film pér misrin e pambukun,  
më qaset e në sup pëllëmbën mbështet.  
Unë e vërej tek thith me qejf çibukun:  
e ku ke qenë, gjysh, i them ti kaq vjet?

Ai më vëren e sytëmbush me lotë  
dhe i shpëton çibuku vrik prej dorës.  
Diçka me rëndësi gatitet të më thotë,  
po këputet në mes ëndrra nga tingëllimë e orës.

Ku mëpëruron në dëgë deri, ku këpucët bës, jepur  
ku alëmonet bësi doqë më dëgë këpucët

(fondovalëzuar këtij kohë përgjithësia e tij)  
A më vëren e sytëmbush me lotë  
(fondovalëzuar këtij kohë përgjithësia e tij)

## SHI BEHARI

Nuk duken nga fillojnë e nga vazhdojnë rrugët,  
ndonëse vërtet është, siç thonë, shi behari.  
Një llurbëtirë, llumore ujë i turbullt...

Një re e murme tërë qiellin mbyll,  
se ulin kryet, siotë trembur drurët.  
Lajthishta shtrihet rreth e qark, si pylli  
e mijëra syllynjarë rrjedhin shkurret.

E ngas rrëkeve e shtigjeve të dhive;  
shkas nëpër bar, në fier, zhytem në llucë.  
Ku mbahem në një qarr, ku kapem pas lajhive,  
ku shembem posi deng në një gëmushë!

E gati, fluturim, zgres buzë Vërbës!\*)  
E zhytem midis valëve, deri mbi ije  
(ndien nën këpucë rërën, që gërryhet tinëzisht),  
më ther si akull ujët e Lenijes,  
porse në breg më pret një jonxhë e gjelbër,  
e larë mrekullisht!

---

\*) emër lumi

Dhe rri vështroj: më njeh këtu çdo shteg  
e monopat.

Edhe symbyllaz mund të arri në fshat...

Ja dhe pejzat e vragave

që dhe në endërr i deklamoj përmendsh prapë  
si bari!

S'ma kishte marrë mendja dot vërtet

që bashkë me kopenë e dallgëve

edhe ky shi, edhe kjo rrugë, edhe kjo jonxhë  
e blertë

do futeshin në këtë poezi

kaq dhembshurisht.

BIBLIOTEKA E RRETHIT

G. ROMAster

50172

## T U R N E T

Po marrim ca thërrime ngrice nëpër çizme,  
diçka nga ky acar, që rrjep fytyrën,  
një guaskë akulli në peliçe  
dhe po ju lëmë dorëzim detyrën.

Një metër borë në sektor dhe borë bie prapë.  
Një metër borë, shokë, në mesnatë!

E çfarë po ju lëmë, shokë, tjetër?

Një lëmë-prush e dru ç'na kanë mbetur.

Dhe po marrim prej jush:

të drejtën që të hamë darkë,  
të drejtën për të fjetur!

Ngarkuar me kristale ngrice çizmet,  
rënduar nga dëborë e re peliçet,  
teksa zhurmojnë në errësirë hapat,  
na presin të kënaqura barakat.

Supa e nxehëtë, që avullon në pjatë;  
ca tinguj familjarë: gota, lugë, enë,  
që veten në shtëpi një çast ta ndiejmë.

## URIM PËR VITIN E RI 1986

E marr urimin tuaj me çelsin elektrik në apartament: mbulon ai me krahë drite si një shpend<sup>dit no</sup> një kalendar, radion, një kartolinë, gotat që presin për urim në tavolinë; shpërndan ca pika llaç, shkund disa grimca akulli, bashkohet edhe tretet, si vegim, me tingujt e muzikës dhe shkrin e gurgullon në pejzat e lirikës:

### GËZUAR!

Dhe ja, po ju përgjigjem, shokë, në sekondë:  
juve që po ju fshik fytyrën, sonte, si me kamxhik  
acar i Alpeve,  
tek ecni në sektor, duke ju shkarë çizmet, midis  
akujve;  
juve që po ju ngrin pëllëmba pas levave nëpër sonda,  
juve që po e prisni vitin në kantier mbi rrota  
me gurzit e pagjumësisë mbi qerpikë,  
duke vërvitur baltë dhe shkëmbinj në digë;  
juve që mes gëzimit me të afërmit do ta gdhini,  
juve që po udhëtoni, në karroceri, mes shiut e  
thëllimit,  
juve që prisni në kabinë një telefonatë,  
juve që s'do largohi dot nga betonimi deri në datën  
2 janar, 1986...

## MËRITË

Juve që s'keni mbërritur ende në familje  
dhe jeni gati që të udhëtoni edhe pesë mijë milje,  
për ta pritur këtë vit të ri më të dashurit!  
Juve që mund t'i ktheni në energji e drithë gjithë  
burimet e lumenjtë në këtë tokë  
bile dhe akullnajat e Groenlandës e të Antarktidës,  
Juve të paharruarit e të dashurit shokë:

**GËZUAR! GËZUAR! GËZUAR!**

mein dico dudu është që nuk është dudu  
(mijë vjetore që nuk është që nuk është).  
Nuk duhet që nuk doqet që nuk është  
mundë njerëzve që nuk doqet që nuk

llojëve që nuk doqet që nuk doqet që nuk  
(flakët nëntorët që nuk doqet që nuk  
është që nuk doqet që nuk doqet që nuk  
doqet që nuk doqet që nuk doqet që nuk)

## MËSUESE

S'më njeh? Kemi udhëtar bashkë në kamion  
e të kam hedhur pallton të mos ngrish.  
Po koha, pa na pyetur, kalon  
(dhe hajt ta kthesht, atë që tret, sërisht).

Por unë vij nga ty, në mbrëmje, shpesh  
e pranë sobës rri, pëllëmbët ngroh.  
Të dy i biem ziles në mëngjes  
dhe pa regjistër nxënësit t'i njoh.

E tok me ta në klasë, unë ulem  
(dhe më pëlqen, që prapë nxënës jam)  
ti herë vëren dëborën që shkund lule  
dhe herë shihesh në pasqyrën xham.

E një sekret nga syri nuk të shqitet  
(s'ka zemër ku Orfeu shigjetën s'ngul!),  
Dhe flet pa zë; sa shpejt që ikën vitet...  
Dhe unë një thinjë, fshehur, vij të shkul.

Shkollarët në pushim po lozin top,  
ti pranë sobës buzëqeshur rri.  
Shqipërinë prap' kërkon me sy në glob,  
në glöbin që me ty në tavolinë rri.

## MIDIS TURNIT

*Kushtuar Heroit tē Punës  
Socialiste Todo Manço*

Todo Manço! Ti je ulur si një shok i njojur  
midis turnit, pa ceremoni.

Dhe me zjarr' e zemér na ke ngrohur,  
pa na thënë fare kush je ti.

Ti me ne ke qenë në çdo çast  
duke ndarë çika shpirtin tënd,  
Pa shikuar askërkënd nga lart,  
ti je shtruar, lirshëm, në kuvend:

Lëre shokun që t'i mbajë sytë drejt,  
mos tē ndrydhet, si iriq, nga heshtja!  
Lëre shokun që tē t'i besojë krejt  
dhe ato që zor i nxjerr nga vetja.

{ Foli tjetrit çiltër, nga çdo kuotë,  
S'dihet ç'gaz a ç'kob e shtyn nga ty!  
Kur tē vëren ndokush së largu ftohtë,  
s'bën mëkat tē shkosh ti, tek ai...

Lëre tjetrin të të flasë sy ndër sy.  
Pse të rriten veshët si lëpjetri?  
Lëre shokun, që të të besojë ty...  
S'ka më nder se sa të të besojë tjetri.

Lëre shokun që të shprehet, si vëlla, pa droje  
fare  
të të qajë ty çdo hall, pa i ardhur turp!  
Pse njeriu (dije mirë) ka në shpirt të vet

dritare

Todo Manço! Ti ke nxjerrë mallin e vetvetes  
në bisedë me të gjithë dhe Partinë.  
Ke kérkuar në tunelët e jetës  
dhe kromidët, dhe rubinët, dhe njerinë.

## VARGJE PËR TIME BIJË

Unë gjithmonë do të të ngatërroj  
me atë vogëlushen me bluzë të bardhë,  
që herë e merrja nga kopshti përdore  
dhe herë e merrja në krahë.

E i përziente bashkë retë, yjet e hënën  
e xixellimin e xixellonjave,  
me kukullat, me nënën  
dhe shoqet e veta të lodrave.

Që më vinte shpesh duke qarë, me gjunjë të  
gjakosur e të gërvishtur,  
duke vrapuar me atë çapin e vockël, një pëllëmbë,  
dhe e shtrenjta nënë i fshinte lotët,  
i lante doçkat e faqet  
e sajonte turli fasha për t'ia lidhur plagët..

E sa herë flasim, tok, të dy e zihemi në debat,  
e sa herë të shikoj në bulevard e në rrugë,  
që shëtit e nxiton në punë,  
e sa herë të dallgëzojnë flokët e gjatë nëpër erë  
më kujtohet prapë ajo vogëlushja flokëverdhë  
me përparëse të bardhë,  
që herë e merrja përdore dhe herë e merrja në  
krahë.

PÖLIC HER TARGAT DHË TIR NIS  
PÖLIC TARTAKU

Dhe më bënte qindra pyetje në ditë:  
për zogjtë, pér qenin, pér ketrin, pér dhelprën,  
pér lulet  
dhe pér të gjithë trupat kozmikë...

Ajo vogëlushja me gjunjë të dregosur e të  
gërvishur  
dhe mezi më besohet që ti je ime bijë,  
dhe mezi më besohet që ti je rritur!

## POEZI PËR TARGAT DHE TIM NIP, POLIC TRAFIKU

Eh, nipçe, nipçe! Që më tund dorën buzëqeshur,  
kur të flas!  
Vëreja dikur një mëz që sulej link nëpër luadh  
e kisha qejf të rendja tok me të,  
Shikoja në hapësirë një skifter e desha që të  
matesha me skifterin,  
Shkreppte përmbi Tomor një shkrepëtimë  
e desha që të jem dhe unë vetëtimë!

Targa! Targa! Ndjek trenat, autobusët e kamionët.  
Janë tanët, nipçe, që të gjithë! Janë tanët!

Vërej, pemët: bliret e mimozat, që mbushin tro-  
tuaret,  
rrugët e bulevardet, ku çapen kalimtarët;  
vërej lisat e ngarkuar me lende e me korithë  
dhe pishat, nëpër pyll, dhe fushat plot me drithë;  
vërej vreshtat, fidanishtet, lumenjtë dhe buronjat;  
janë tonat, nipçe, që të gjitha! Janë tonat!  
Dhe kur shikoj, që shqyen kush fidanët,  
më vjen sikur t'i shkulin ty që të dy krahët,

## A R O A H

Dhe kur ndiej se dikush shemb një mendim rinor  
e një këmbë ure shemb,  
si në apendis akut, gjithë qenia ime dhemb!

Dhe kur ndokush i qit mendimit palcën, që ta  
mbytë,  
më vjen sikur t'i nxjerr nga zgavrat, nipçë,  
të dy sytë!  
Targa! Targa! Vërej serat, lulet, ullinjtë e  
portokallet

(sado larg që të ndodhen!).  
Urbanët plot me njerëz, anijet e avionët, më  
vërej Drinin, Vjosën, kodrat, grykat, malet,  
janë tonat, nipçë, që të gjitha! Janë tonat!

## R A O R A

*Shokëve të mi, të Vaut, të Dejës,  
Fierzës e Komanit, që punonin e më-  
sonin.*

Shokët e mi dhe bijtë e mi të dashur,  
kërrusur në tryezë përmbi libra;  
me raportorë, kompase e rriga,  
një vesë dheu ju shket nëpër fletorë.

Ju vetëm zgjuar në fjetorë!

Shokët e mi dhe bijtë e mi të dashur,  
s'merr mbrëmja frymë e shqetësuar, po marrunë.  
Jam ulur, pas dritares, si kaçubë.

E di se nesër ju pret shkolla;  
e di se sa të shtrenjtë e keni gjumin...  
Po kur të zbresë sa mbi grykë hëna,  
më duhet t'ju bëj zë, të marrim turnin.

Po, dale, ç'më shikojnë sytë?  
Papritur varni kokën mbi tryezë  
dhe flini...

Por unë, që kaq afër ju kam njojur  
dhe e di sa fort që jeni lodjur —  
dhe si dremitni, në pushim mes pluhurit  
me faqen mbështetur mbi një pllakë guri —

Duhet t'ju zgjoj.

Ju flini mbi fletore dhe mbi libra.

E ç'ëndrra po shihni?

E ç'fluturime ndër nebulozat trëndafil, nëpër agime?

Dhe unë duhet që t'ju zgjoj!

Oh, ja tek vjen ngadalë, majë gishtave,  
sikur të shkelë majë iksave —  
i madhi Faradej!

Ju puth me dashuri në faqe e në ballë,  
pa thënë asnjë fjalë,  
(ndofta nuk do t'ju prishë gjumin.)  
e ju lëshon një grusht xixëllonja më te koka.

Kantieri mbushet plot xixëllonja.  
Plot xixëllonja mbushet gjithë toka.

Dhe unë që ju dua kaq fort  
duhet t'ju zgjoj nga këto èndrra të bukura...

E flas me ju pa zë. Ju përkëdhel.  
E çapem, plot shqetësim, me hënën, tok në quell,  
E murmurit menduar sa shpejt që ikën koha.

Shokët e mi dhe bijtë e mi të dashur:  
Zgjohuni! Ra ora!

## SE DUA TË MENDOJ QË JAM VËRTET NË FSHAT

Ne pimë deri vonë, megjithëse isha lodhur.  
Shoshitëm, duke pirë, çdo gjë që kishte ndodhur.  
(Në pije qimja ndan një fakt nga çdo përrallë!)  
E thirrëm në dolli të vdekur e të gjallë  
dhe pasi zgjidhëm, plot sukses, thuajse çdo  
problem,  
vendosëm më së fundi që të flemë.

— Ja shtrati, — thotë im nip. — Natën e  
mirë! —  
Mbështetem i kënaqur në krevat,  
fik abazhurin, që të ngelem në errësirë,  
se dua të mendoj që jam vërtet në fshat.

Por prapë shqetësimet nuk më hiqen,  
ndonëse bien erë sapuni teshat.  
Ja, sa andej-këtej lëviz edhe përpinqem,  
sikur po më sulmojnë mijëra pleshta:

Vërtet, këtu tani kërrkund nuk mungon buka  
dhe s'mund të na vrasin më as shiu, as moti  
i thatë.  
Por prapë s'e lëmë dot ne shatën edhe sfurkun  
dhe kostoja e grurit del e lartë.

SE DUA TE MENDOL QË TË VËRTETT  
NË FSHAT

Ka ikur fshati i ri nga prapambetja  
dhe kozmosin shikon me trëndafilët e yjeve,  
Por hajt të dalim thuaj nga vetyetja:  
nga një miqësi, një krushk, një pus me karavidhe..

Dremit... në dhomë, bie heshtje.  
Oh! Ftonjtë, si të gjallë, lëvizin nga sënduqet.  
Shih ç'ftonj që më ka prurë prapë gjyshja e  
mirë me vete,  
ndërsa nga çdo parmak koncert po japid bulqet.

...  
...  
...  
...  
...

...  
...  
...  
...  
...

## SHI NË GUSHT

Një pelë reje vrapon pa kapistër  
nga Mali i Thatë, deri në Lenie.  
Ia ndien revanin një korije misër  
dhe qafon shelgun një gërshtet hardhie.

Pa, në sekondë, nis një shi i bardhë —  
ka pesë muaj pa pikuar pikë! —  
Verdhon në degë çdo llambushkë-dardhë  
bretkosë e gjelbër hidhet të shëtitë...

E bëjnë banjo: arra, mollë, e kumbulla,  
e hapin sqepin, që të pinë, zogjtë.  
E dridhen pemët, shkundin dhemje e pluhura  
dhe shelgu i heshtur, këngës prapë ia thotë!

## K U S H K O N

*një mjekeje*

Më je fiksuar e pérthinjur në kujtesë rrugicave me urgjencën!

Nxitoje drejt pacientëve si erë kudo që ata prisnin.

Dhe i kuptoje ti fëmijët menjëherë si do që të të flisnin.

E ndonëse nuk u bëre kurrë nënë, ti s'ngèle kurrë pa kalama në krahë, E ku të thirrën ata dhe s'ua ndjeve zëhë, moj nënëz flokëbardhë?

Shqetësoheshe dhe brengoseshe aq shumë, me brengat e të gjithëve duke jetuar pa kurfarë zhurme e dashur dhe stoike.

E mezi gjeje kohë t'u gjëzoheshe luleve, që aq fort i deshe.

Ndaj trëndafilët rrinin kokulur, tek prisnin që të ktheheshe.

## КЕДИНАД МИЛАНДА

Dhe s'shihje dot, që me nxitim po rridhnin,  
si pa u vënë re, muaj e vite.

Ty vogëlsirat, motër, të mërzitnin  
e fare pak mendojti për vete.

Dhe thuajse pa pandehur të pushoi ty zemra,  
zemra që tërë jetën sulet.

Jo! Kjo nuk ngjau nga thinjat as nga dhembja,  
por nga malli për fëmijët e për lulet!

## KERRKUND NUK JEMI VETËM

Nga një ndodhi në Memaliaj  
Ti kishe kohë të largoheshe, Telo,  
I pe tek po harbonin minjtë,  
(kasnecë katastrofash!)  
dhe mund t'i ikje ndeshjes nën tokë.

— Na mbeti Maloja, shokë!  
Ju ishit vetëm dy në atë oxhak.

Dhe shokët ishin larg....

E pe përpara Malon, tek anohej,  
dhe dritën e kandilit, si në mjegull,  
dhe mund t'u jepje këmbëve të largoheshe,  
pa shkelur asnje rregull.

Karbiti zu të digjej me ngadalë.  
Maloja ra, pa thënë dot një fjalë!

Dhe ti e ndieje, Telo, vdekjen që afrohej  
dhe kishe pak sekonda të largoheshe.

-NIKO BELO-  
SHTEPIA NDI AYTA  
DILIRE

Të ngopeshe me oksigjen përjashta  
(oh ç'mrekulli të thithësh ajër të freskët!),  
të pije një raki me meze qefulli — tok me shokët,  
t'i shpleksje nuses flokët  
e të jetoje... dhe mbi një gjysmëshekulli!

Po ti s'u ktheve, Telo.

E ndonëse nëpër terr po mbytej galeria  
e çdo sekondë ndihej tek po priteshe,  
ti këmbadoras me shokun tok zvarriteshe...

Dhe bëje të pamundurën që t'i shpëtoje jetën,  
me një mendim në zemër:  
ne, punëtorët, kërrkund nuk jemi vetëm!

Kështu e mbrojte shokun ti.  
Dhe ngele tok me të në një oxhak në thellësi.  
Por fjalët prap' te ne që nga nëndheu zatetën:  
Ne, punëtorët, kërrkund nuk jemi vetëm!

## IKJA NGA SHTËPIA «NIKO BELO-JANIS» DURRËS

I dorëzova që të gjitha:  
parketin e lagur buzë detit, me gjurmët e kalimtarëve,  
hutimin e shkurtër të mëngjeseve, midis plepave,  
shushurimën e shqetësuar të valëve,  
imazhin që ndien njeriu kur vëren i menduar në  
dhe flet, me hapësirat e me iveten e vet.

I dorëzova që të gjitha.

Një shportë guaska, mbledhur nëpër stere e nëpër ujë,  
muzikën e zërat e plazhit, plot rrëmuje, vajzat e qeshura me kapuçë prej dallge mbi krye, paradën e trupave me kostume banje, mbuluar me pika uji, rreze e thërrime kozmike.

Asgjë nuk po marr me vete.

Diga, statujë, arinj e qytete, ngritur prej fëmijëve  
një pulëbardhë që tundet nëpër valë, si kaike  
dhe gjithë floririn e rërës,  
në këtë mbretëri të madhe fantastike.

Ja tek i ke, Niko Belojanis, merri! — i thashë.  
Dhe ndaja kujt të duash:  
në daç turnit tjetër që po vjen,  
në daç tërë punëtorëve të dheut.

Ne, të gjithë kalimtarë, vijmë dhe shkojmë  
në këtë qytet të pavdekshëm.  
Këtu ti je i përjetshëm, o Niko Belojanis!

Ti edhe deti.

## PSE HOVËT GJER KËTU

Kolona milingonash deri në kat të pestë.  
E nga na erdhët ju?

Nga toka a nga retë?

Ngarkuar kokrra gruri, mbushur me farëra  
barërash.

E nga na bujtët ju?

Prej vreshtash a prej arash?

Rënduar me zahire e grimca luledielli,  
me bar e me insekte,  
edhe thërrime meli.

Pse hovët gjer këtu?

Të më cimbisni pak, a për të më qortuar,  
se nuk ju kam takuar,  
gati, një gjysmëjete?

Apo për të më marrë hipur mbi një kombajnë  
prapë në lëmenj me vete?

## TEK PO ÇEL E PARA DITË E VERËS

Ecën i menduar një kortezh,  
hapat, shpesh, kërcasin nëpër brymë,  
Unë plot mundim sot këmbët hedh  
sikur me buldozerë po më shtyjnë.

Ndjek në këtë «marsh» qivurin e nënës, —  
tek po çel e para ditë e verës.  
Vetëm s'shtyhet dot kothere e dhembjes,  
dhembja, si gjithmonë, shkon me njerëz...

Oh, diçka mungon në funeral!  
Përroi që zbret prej pishave dhe staneve.  
Ura e ylberit mal më mal  
dhe floriri i bisqeve të thanave.

Por në vend të luleve bukuroshe,\*)  
që na shtrojnë kësaj dite rrugën,  
erdhën burra e gra me kominoshe  
nga fabrikat, posa lanë punën!

---

\*) Ditën e parë të pranverës fëmijët hedhin nëpër shtëpitë që vizitojnë lule thane

THE PO CER I PALA DIL A LENIA

Nënë, zbritur nga Lenia e largët,  
lamtumirë — shih kush po të thotë!  
Dhe më duket ky qytet i afërt...  
Ndofta, më i bukuri mbi tokë!

Hënëtëm i caktuar vajzë  
vendos së përmes kësaj fëmijës  
fëmijët e tij, që  
nëpër vajzët e tij.

Qëndrueshmëri  
nëpër vajzët e tij  
nëpër vajzët e tij  
nëpër vajzët e tij.

Qëndrueshmëri  
nëpër vajzët e tij  
nëpër vajzët e tij  
nëpër vajzët e tij.

## ARMIKU I KLASËS

Armiku nuk del sot me pallë sheshit  
se është elastik e mjaft i mbledhur.  
Dhe, shpesh, ai na çuçurit te veshi  
ndonjë këshillë apo citat të zgjedhur.

Por rrëzave ku mbi rrogoz ku nën rrogoz,  
ku duke ecur majë gishtave thua më thua;  
ku me të qeshur, ku serioz,  
të çuçurit, si pa të keq:

Ç'më duhet mua?

Të ngjitet pas, gjithkund,  
si balta pas këpucëve:  
të miraton, të kreh, të ngre...  
E shan ndokënd, si rastësisht, ashtu me cep të  
buzëve  
dhe prapë të çmon guximin, prirjen e përv-  
jën;  
të vlerëson, nuk ke ç'i thua!

Një gjë të vogël vetëm do ai:  
të kyçesh cep më cep ti gojën,  
me bravën e ftohtë: «Ç'më duhet mua»?

## СЕВАСТОПОЛЬСКАЯ

Armiku kapet fort pas llafazanëve,  
dembelëve dhe prepotentëve,  
si grigja e çakajve pas kërmave,  
edhe rinohet krejt, edhe ndien lumturi,  
kur shton (edhe me një) numrin e indiferentëve,  
kur vëren se në atë «librin e vet të të vde-  
dhe një i gjallë u shtua.  
Ç'më duhet mua?

### *Sinus tubercularis*

## BALADË PËR UJIN E BEKUAR

Po Vojtila! Ti je bari në qiell edhe në tokë.

Jo më kot bari e prind ty bota nuk të thotë.

Po, kur ke ti mish e treqind vjeçë verë në Vatikan,  
pse harbon kot breg më breg e oqean më oqean?

Nga Meksiko në Nairobi, pse po turresh kaq me  
ngut?

Nga Varshava në Kalkuta, Salvador e në Bejrut?

Dhe ashtu si të ka hije, jo për dukje e reklamë,  
tund ti një mantel të bardhë edhe një i brik të artë.  
E kudo që ti vë këmbën, fill në çast për mrekulli  
dhe nga qielli, lot i kthjellët, nis që të pikojë shi!

E nis mbjell pa çarë kokë: palma, fiq, edhe banane  
gjer në pol te pinguinët midis akujve kallkane...

Flitet se edhe mushkë e nëmur po të pijë nga ky  
ujë —  
jau them në vesh, ngadalë, po sakën se e bëni  
bujë —

jo një qyp apo një shtambë, po një lugëzë kafeje:  
mund të pjellë në tre muaj një goxha kërric deveje!

Flitet se kudo që shkon ti, bari, qull hallexhinjtë,  
rërën që po mbyt Afrikën, me gazelat e gjarpërinxjtë.

Dhe kështu i përdëllyer ti prek botën anembanë;  
lan, në çast, dhe ato duar që «si lajnë oqeanë»!

Dhe xhelatët, të mahnitur, prej çdo race dhe çdo  
feje,  
vijnë me avion special, bien gjunjaz para teje.

Sigurisht, si kanë vrarë e kanë therur me milionë,  
ca Suharto, ca Trumanë, Pinoçetë dhe Neronë.  
Të penduar gjer në mykë, duke dënesur, duke qarë,  
shtrirë duart, duke u dridhur, t'u lash ti sa më parë!

Edhe ti, o at' i shenjtë, mbytur nën një gurrë lotë:  
— Mëkatarë, — nis qan hidhur, — fuqimadhi ju  
shpëtoftë! —

Dhe i qit në çast nga burgu, dhe u lan në çast çdo  
masë  
dhe i nis të çlodhen pak dy-tre muaj në parajsë...

Flitet shpejt pranë cisternave, nëpër detet e trazuar,  
do vozitin dhe cisterna plot me ujë të bekuar!

C'fat i madh pér botën! Amin! Amin! Amin!

## HORIZONTE

Vijinë shtëpinë e prindërve, prind dhe vetë.  
Dhe qeni leh i egër e idhnak.  
Balo, ti mos u çmend! Jam bir, në këtë prag,  
S'më prët si zakonisht, në qoshk im atë.  
S'del nëna që nga kopshti, me këmbët tërë baltë.

Vërej misrat, si korije; vërej arat plot me drithë,  
Vërej njerëzit e afërt, ndonëse s'i shoh të gjithë.  
Ata më buzëqeshin çiltërsisht, disa më njojin.  
Të tjerët më hetojnë pak si larg e tjetër soj më  
shohin.  
Vogëlushët dalin që nga qoshet, e vërejnë si më  
kot.

Dhe pemët më qëndrojnë, si të shurdhëta,  
sikur s'këndojnë nëpër degë zogj!  
E ç'pikë qenkat sot që plasen kaq të kundërtat?

E ç'tel më cicëron mua në zemër,  
Shih, eci nëpër gurë, sikur çapem mbi èndërr —  
kur sulet një re shiu, që nga Bodeja,  
ndofta të njomë ballin kjo poemë,  
dhe shkrepëtin përmbi Pupul rrufeja,  
ku nipi im ka ngulur një antenë!

## Э Т И О З И К О Н

Kënaqem sa më s'ka kur shikoj grurin det  
në fshatin tim malor, gjer në Lenije!  
Por çdo qelizë nëpër trup më dhemb  
e nuk më imban dot vendi,  
kur vërej tek imbin si gjemb indiferenti  
dhe merr përditë tri norma nën hije!

Po. Prapë mund të ma heqësh veshin ti, lexues,  
pse dënes prapë ky njeri për pjergullën me  
rrush? Vëllitet mal më mal e s'gjen kërrkund qetësi  
edhe çukit si zog çdo kumbull e qershi.

S'ke ç'bën: shëtit mes galaktikash në univers  
e zbret të çlodhesh nën një man tek ara.  
Kujton plot nostalgji atë që shkon e vdes  
dhe sytë i mbërthen gjithnjë përpara!..,

Vij në shtëpinë e prindërve, prind dhe vetë  
Këtu në këtë truall janë ngjizur  
stërgjyshët, gjyshërit, prindët ... unë vetë!  
Porse gjithçka ka ecur. Ka lëvizur  
Gora ime! Ka lëvizur Lenia vetë!

Por s'mund të hovkan, kurrsesi, njerëz e male  
pa u përplasur dallgëve, mes dhembjeve.  
U dashka që të bluajmë çdo shkrep e çdo  
kokallë,  
për të montuar boshtin e një kënge!

251701-9 31122909 . M

## NË RRUGË...

I ngjitem majës-thikë, drejt përpjetë,  
ku janë ngrënë, si me limë, gurët.  
Kaloj këtej tani pas dyzet vjetëve,  
janë gërryer e thelluar rrugët.

Ndofta takoj gjithë shokët që kam pasur,  
Bile edhe ata që s'çapen më në tokë.  
Dhe del më pret, sërish, prapë nënë e dashur  
më një çati dëbore, përmbi flokë!

Po ngjit një shkëmb. Më tej dy shkallë zgres:  
ja tek më pret një gurrë e kulluar!  
Më çik një shelg. Më fshik një degë bredh.  
E befas zihem rob mes pishash i rrethuar.

Kur pak më tutje nis fëshfërimën spanjë!  
Një këngë të harruar ti, cinxër, vërvhellen.  
E më bën zë të më gostitë thana,  
dhe një gushkuq më thotë: mirë se vjen!

Prapë rruga zbret nga kodra. Në një gropë:  
ca bajga kuajsh. Një gjëmb. Dy trumba bar,  
Më tej një rrap i çarë në dy copë:  
një top gjerman dikur ka hapur zjarr!

Por zhdukет rruga përsëri  
mes dushqeve, shkorreteve e kulprave.  
Dhe unë i hutuar, s'di se si,  
gatitem t'u thërras si udhërrëfyese fluturave.

Po ata ikin larg, pa më dëgjuar.  
Ndofta nuk u pëlqen trishtimi i një lirike?  
Dhe ngelem midis pyllit i menduar...  
— Këtej! — më vërshëllen një linjë elektrike.

Dhe unë ndjek me ngut rrugën që më tregojnë,  
pas kabllove që tundin zilet në erë.  
Karriere partizane, shtyllat më shoqërojnë,  
nga Guri i Kamjes gjer te Guri i Prerë.

## NENA SIBÉ

Ka mbi dyzet vjet që i mbaj në xhep  
tri kokrra dardha:  
m'i ke dhuruar ti nga Çereneci, o nënë Sibe!

Sa herë më thahet buza,  
i kafshoj e më mbushet goja plot me lëng.

Tri kokrra dardha,  
të ëmbla e të verdha, si lagjinë të artë.  
Sa herë më hidhërohet gjuha,  
i kafshoj e më mbushet goja mjaltë.

Tri kokrra dardha!

Sa herë më dhemb zemra,  
u marr erë dhe më pushon menjëherë dhembja,  
e nënë Sibe!

Ka mbi dyzet vjet që i mbaj në xhep  
tri kokrra dardha;  
që m'i ke dhuruar ti, o zemërbardha partizane  
e Dibrës.

Tri kokrra dardha...

Që sa më tepër shkojnë vitet,  
aq më të ëmbla bëhen!

## PRIFTI

— Merr këtë prift, — më thanë prerë —  
në bazën numër dhjetë e shpjer! —  
Dhe unë e marr pa kundërshtuar,  
pak kureshtar, pak i hutuar...  
Pa shih, mendoj, s'e ç'prift tuaf  
me trë pëllëmbë kamillaf!

Mjekrën zi-korb, një pashë të gjatë,  
varur në gjoks një kryq të artë:  
bir, marshallah, ç'bandill uratë!

Nga këmba çalë, nga gjuha çalë.  
E pse nuk flet, dobarë, një fjalë?  
Ka prift memec, në tokë, vallë?

Por prifti çapet madhështor  
me kryq floriri në krahëror  
dhe s'pyet ke baba e nënë,  
ke ngrënë bukë a s'ke ngrënë,  
ke çfarë vesh e çfarë mbath,  
ke zjarr në vatér apo mardh?

Bile as që më vëren në sy:  
— Ore, ç'inat që paska ky! —  
Dhe tekxa çapemi në llucë,

## ELBA

pllaq-plluq bën këmba në këpucë:  
Si një njeri prej feje tjetër,  
më bren një shqetësim i vjetër  
dhe një mendim më shpon si gozhdë:  
të qe, të paktën, ndonjë hoxhë... —

Por unë si korrier partie,  
me krenarinë e një fëmie  
në bazë, prapserapë e shpie  
dhe iki shpejt pa bërë llafe;  
Shyqyr, mendoj, e hoqa qafe!...)

Po, kur kaloi një vit, më thanë:  
ti shoqërove «Prift» Tarzanë!\*)

Si prush më dogjën lotët mua  
e nisa që të qaj pa zë,  
E pse mendova keq për të?  
E pse mendova keq për të?

\*) Pseudonim i Heroit të Popullit, Vojbë Kushi, komandant i njësive guerrile të Tiranës.

## E L E N A

Jemi në një skuadër:  
unë, Foto Paolo siçiljani  
dhe dhjetë partizanë.

Një peshkatar nga Siçilia,  
tjetri fshatar nga Gora.

Në riska misërniken shpesh e ndamë  
ne, dymbëdhjetë partizanë.

Pushonim te burimi, nën një pemë  
dhe, teksa vërenim luleshumin maj,  
na fliste Foto Paolo për Elenën  
(kalonte dorë më dorë fotografia e saj)

dhe mitralozin nuk e linte kurrë.  
Korabin ngjitnim bashkë nëpër vapë;  
prapë për Elenën fliste dhe në rrugë  
e tërë ëndje ne dëgjonim prapë...

Si shkoj ca kohë, katër shokë u vranë  
në Dibër, Martanesh e Peshkopi.  
**Po mbush skuadrën kënga partizane,**  
zëri i përrrenjve dhe Elena e tij.

## УКАЗАТ

— Një ditë, papritur, nën një zjarr të fortë  
dy cifla predhe më plágosin keq.  
— Jo, nuk të lëmë! — Foto Paolo thotë,  
nëpër rrëbesh skuadra më terner!

Edhe nën tendën plot me degë panje,  
(me një kuti reçel që s'di se ku e gjejnë)  
vjen në spital skuadra partizane;  
dhe siciliani,  
dhe shoqja jonë Elenë!

Ulet mbi fier e pos i motër flet,  
tërë kujdes që të mos më lëndojoë...  
E ngelet në skuadër, si në shtëpinë e vet,  
më e bukur shtatëfish se sa Elenë e Trojës!

## T A N K U

Dëshmorit Hamdi Lleshi, i pari tankist  
shqiptar, që ra në 1943

Hamdi Lleshi që nga tanku grin,  
hapen krismat breg më breg, në Drin!

Dibra e Madhe, shtatë herë nënë,  
don t'i thotë çfarë s'i ka thënë,  
don t'i nisë birit të vet një këngë...

Dyzet topa tankun marrin shenjë!

Gjenerali cirret plot poterë,  
nga inati desh e çan gabosherrë;  
dyzet topa shkrehin menjëherë!

Zjarr lëshojnë nën zinxhirë gurët,  
tanku i egër më me duhmë turret!

Gjenerali tankun vëren me ankth,  
(s'ka rrufe që nuk vërvit mbi tank!)

## DASHURI

nga inati gizmet plas përdhe,  
prej tërbimit as dëgjon, as sheh,  
digjet prush dhe akull i ngrin shtati:  
divizioni «sulmin» nis së prapi:

Urë e Spilës mbushet flak' e tym,  
Hamdi Lleshi mes ushtrisë hyn!

Tym i zi gufon mbi tank përpjetë  
— Ja kush jam! — qesh gjenerali i rreptë.  
— Ja kush jam! — më tej s'arrin të mburret:

Kallur zjarr, drejt tij prap' tanku turret!

Nëntë malet, që nga qielli vërejnë. ëp  
shoku shokut tankun i rrëfejnë...

Dibër e Madhe, që i dha trimit emër,  
dhe një djepe, dhe një mollë zemër,  
dhe një lule, që kuqlon të ritë,  
dhe një besë, dhe një fjollë dritë,  
dhe një mall që nuk ka shok të dytë:

Nga dritaret s'po ja shqitka sytë...

## D A S H U R I

Poetit Gj. Kuqali

Ti gati në çdo resht «kur do të vish» më thua.  
Në letër nga mërzia mezi lidh fjalët bashkë.  
E, në një cep të saj ti e habitur shkruan:  
«Pse ikën prapë nga unë, përherë dhe më larg»?

Ta dish sa ëndje kam të fluturoj te ty  
dhe njëqind postëblloqe fashistët të më vënë!  
Të paktën të të shoh një çast që larg me sy.  
Të paktën të të ndiej dy-tre sekonda zënë...

Por mund të ikësh dot, më thuaj, nga kjo luftë  
tani që ndan njeriu çdo pikë gjak me njerëz  
dhe del ai përditë më i bukur nga çdo skutë  
dhe herë i ngjan shiut, e herë i ngjan erës.

E herë, pas një fluture, në ëndërrime bie,  
e herë, pas beteje, mbështet kokën në shkëmb.  
E herë bëhet rreze, e herë bëhet hije  
dhe tërë dhimbja e dheut nëpër çdo ind i dhemb!

Pse më shikon, nga larg, posaçë e panjohur  
e më qorton, në heshtje: Po ky pse nuk përgjigjet.

Pse pyet me shqetësim: Më thuaj ti çka ndo-  
dhur»?!

Kur ti dhe vetë e sheh që globi zjarr po digjet.

Por unë asnjë çast s'ta marr pér keq mérinë.

Nuk éshtë punë e lehtë tē lësh një udhëkryq;  
tē bluash në mulli nga trupi tēnd çdo brinjë  
dhe në çdo kënd që shkel t'i shpallësh zotit gjyq!

T'i shkulësh ferrat dheut, tē zhdukësh mur e klasa  
e buzëgaz tē hysh në çdo krater mynxyre,  
qëjeta dhe njeriu t'i ndërrojnë krejt përmasat,  
sa tē çuditet dielli nga bukuria e tyre.

Tani, ti, më beso: nuk jam dhe pa tē meta,  
por njeriu lind pér ditë mes provave tē rënda.  
Jo s'do guxojë dot që tē na ndajë as vdekja,  
ndonëse ajo kosit dhe trëndafilë dhe gjemba.

E dashur, sot çdokush jeton çdo çast në ethe  
dhe shumë shokë tē afërt thërrasin pér hakmarrjen.  
E di që në takim çel dashuria gjethë,  
por s'e njeh dashurinë kush nuk ka njobur ndarjen!

## L O L A

John Bald is *Heroinës së Popullit* F. Myteveliut epi  
M. Gjergji

Kazermat gri lëvizin nëpër tym  
dhe Dibër e Madhe mbyllur midis telash.  
Ti, partizane, drejt mbi topat mësyn.  
Gufon nga kapa një buqetë krrelash.

Ç'ka ndodhur, Lola? Ti vërtet ke mbetur?  
Ne s'ka një orë që hodhëm lumin Drin.  
E quajmë kot njerinë gur e hekur,  
kur s'ka metal që zjarri nuk e shkrin...

Ç'ka ndodhur, Lola? Ti në burg vërtet?  
Ti në Gestapo. S'të lënë në gisht thua.  
Po ti mes gjakut, gjak mbuluar krejt:  
një gjysmëfjale s'thua...

Dhe natën vonë zbret në birucë hëna  
illegalisht e të lëmon në flokë.  
— Lola! — bëzan nga dritarja nëna  
e dorën tund Themistokli i brontë.

## ЛУНАРНА СИМАЯ

— Lola! — ti vjen nga shkolla plot me libra  
dhe një komunikatë fshehur në gji.

— Lola! — të shtron me lule tërë rrugët Dibra  
dhe krejt e mrekulluar qesh pa pushuar ti!

Lola! — e çmund të thonë sonte fjalët  
e kjo xixëllonjë ëndërr që s'të ndahet?

Lola! — përplas liqeni i Ohrit valët,  
ndërsa papritur hëna nis të hahet...

Lola! Jo ti mes borës kurë nuk na ngece,  
ti në Komunë sulesh shumë larg!

Lola... je shtatëmbëdhjetë vjeçë  
dhe s'di kë do më shumë, kë do më pak...

—  
—  
—  
—  
—

## RAMIZ VARVARICA

Retë s'rridhnin shi, po rridhnin lavë,  
majave të shkrepave takoheshin.

Interbrigadistët si shokë të afërt  
dhjetëra gjuhë flisnin e kuptoheshin.

Po Kolonë e 5-të tërë «lotë»:

— Nuk i bhet murit dot me kokë!  
— Hesht! — përgjigjet vrik Ramizi ynë,  
pa ia hequr lumit Ebro synë.

Marokenët kishin marrë krahët  
dhe «s'u dilej para» marokenëve.

S'kish njeri që s'kishte disa plagë:  
rridhte gjak prej pesë kontinenteve...

Dhe Ramizit i shkurtojnë këmbët  
bombat e junkerëve, si me sharrë.

Dhe Kolona e 5-të si ndër dhëmbë:  
— Ke akoma shpresë, djalë i mbarë?

— Mjaft! — me neveri Ramizi shfryn  
dhe në baltë plot inat e shtyn.

Dhe fuqi si një kreshniku i lindin,  
tek vështron pas supeve Madridin:

— Non passaran! —

Dhjetëra herë i thyen marokenët  
dhe u futi legionarëve tmerr!  
Po Kolonë e 5-të prapë ferrë:

— Kot e keni, shokë, që luftoni!  
Kot bësoni në revolucionin.

— Shporru! — me tërbim Ramizi thotë  
dhe këmbalkën i vërvit në kokë!

Dhe ju flet ai të gjithë popujve,  
dhe ju flet ai të gjitha kohëve:

— Jo, Madridi nuk u shemb prej minave  
as nga tanket e topat e ESS-esëve,

por nga thikat që mori pas shpine  
fshehur pas ullinjve të kongreseve! —

Dhe këmbalkë e tij kërcet mbi tokë  
duke thirrur prapë në Ebro shokët.

## PETRO N. LUARASI

*Martirit të shkronjave shqipe*

Të dashurit stërnipërit e mi,  
kur do të shkruani emrin Shqipëri  
dhe emrin krua, yll e hënë,  
dhe emrin vatër,  
dhe emrin mëmë

Po të mos kini ngjyrë për të shkruar,  
thirrmëni ju, pa nguruuar mua.

Do t'ju dëgjoj, për nder, ja ku zë be,  
dhe baltë po të jem,  
dhe popël dhe!

Të dashurit stërnipërit e mi:

kur të shkruani emrin diell e djersë,  
dhe emrin flutur,  
dhe emrin shpresë,  
dhe emrin mbarështues dashuri,  
dhe emrin erëmirë manushaqe

ПЕТРО Н. ЛИМАРСА

Po të mos kini ngjyrë,  
thirrmëni ju, menjëherë, pa ngurim.  
do vij kudo të ndodhëm fluturim.

Dhe zemra ime prore do burojë,  
jo një penickë po një lumë bojë!

Të dashurit stërnipërit e mi,  
kur do të shkruani emrin fshat e plor,  
dhe emrin dritare,  
dhe emrin theror,  
dhe emrin zjarr,  
dhe emrin aq të bukur, abetare

Po të mos ju ndodhet bojë në kallamar,  
thirrmëni, për besë, po ju them,  
do t'ju dëgjoj në çast kudo të jem

dhe do sajoi pér ju, si çudibërës,  
prej gjakut, baltës, helmit dhe prej rërës,  
jo një penickë bojë, por një det:

Të shkruani shkronjat shqipe, mijëra vjet!

## SEF KOSHARJA

Sef Kosharja, o i urti i fshatit:  
tri ditë larg të ndihet hapi,  
tridhjetë plagë të ka shtati.  
treqind vjet s'të del inati!

Sef Kosharja, nder i fisit,  
kokën gjer te majë e lisit,  
gjylja, heu, në grusht të krisi:  
— Nuk më vret, — the, — pis i pisit!

Tund pashai fermanë-hekur,  
tokën flakë duke ndezur,  
nuk lë gra e pleq pa rrjepur:  
— Dua Sefën, gjallë a vdekur! —

— Pashë, kot po ia bën benë;  
nuk ka krajl që kap rrufenë! —

Sef Kosharja, zog sokoli,  
gjithë Kosovën plumb e mbolli,  
gjithë Kosovën zjarr e mbushi:  
tre mijë vjet mos fiket prushi!

III. *Different types*

## RRJEDH NJË PËRRAU

Rrjedh një përrua, aty, sa nën dritare.

Herë çap i menduar, herë s'dëgjohet fare.

Herë më kap në befasi,  
duke ju rënë zileve si dhitë.  
Nxiton me link kur bie shi,  
vë syza qelqi nëpër ngricë.

Rrjedh një përrua.

Herë grindet plot potere  
edhe shket, fshehtaz, në korije.  
Më vërvshëllen një këngë erë  
e ku të dojë ai më shpie!

Rrjedh një përrua.

E luan marsh, si në orkestër,  
e bimët mënd, tek ngjet në ara.  
I bie çiftelisë së vjetër  
e tjetër kënd thërret përpara!...

## RÄTTEL NIE PERRAU

E bukur maratonë e tij:  
Kurrë në vend një cast nuk rri!  
Perre s'që dojper lise

Hinc utq. quis en pessari  
quale in longa viae si dñe  
Nexxum mo ilius qui sit ap  
et sicut deidi nupti uulgo.

Rätek nje bëtina

Hinc quoniam qd. postea  
quod spicciat in porto  
me amissum illa ferme atq.  
e tu et qd. si me affici!

Rätek nje bëtina

Et quod in seculis a  
et qd. perit ex a  
I pie dilectio ea vñet  
e letat raud tñrunt bñpina!

## T I

Ti sheh një pemë dhe mendohesh.

Ti vëren një re edhe hutohesh.

Ti ndien një këngë e befas zgjohesh!

Ti je si pikë e vesës, që posa shfaqet tretet.

Ti je si rreze e diellit, që ikën edhe mbetet.

Ti je si krahu i flladit që fryn në zheg të verës.

Ti je si gurrë e kthjellët,

që kurrë s'di të shterësh.

Ti je si lule e dritës, që shpesh me hijet matet.

Ti je si ëndërr e brishtë,

që bredh gjithkund e s'kapet!

Ti je si yll i largët, që ujë pi në krua.

Ti, je si mbrëmje e majit,

që bie erë ftua.

Ti je si xixëllonja që në lëmenj shkërmotet.

Ti mbrëmjes qesh me hënën

dhe ditën qesh me shoqet!

## D E T I

Sonte jam għidher dy hapa larg nga deti.

Më ka pērkundur tērē natēn vala,  
më ka kallzuar kushedi sa pērralla,  
më ka shētitur nēpér det mbi shpiné,  
më ka takuar me yje e delfiné,  
më ka habitur me lulishte algash,  
më ka ndērtuar njé qytet koralesh,  
më ka humbitur nēpér ishuj-breshka,  
më ka vērvitur pērmbi dallgħet-kreshta;

më ka pozuar miliarda reflekse,  
më ka treguar peshq e nēndetse,  
më ka hutuar me dyndje e batica,  
më ka dhuruar perla e karfica,  
(bizħuteri e Trojēs, fsheħur nē funde detesh:  
ta mbash nē gushē ti pas shtatē mijē vjetesh.)  
më ka magjepsur me orkestrën erē,  
më ka fundosur... dhe prapē më ka nxjerré.

E më ka lēnē po nē breg,  
prapē duke ēndērritut:

Pēr njé takim tē ri dhe më tē shumēpritur!

## LIRIKË

Këtu, në këtë poezi,  
ku në çdo germë rri menduar ti  
dhe më vështron me ata sy që presin,  
që herë ndjellin shi e herë <sup>ja</sup>leshin:  
po vë një fjalë, që më the në rrugë  
dhe çau si vetëtima qiellin e mugët!

Këtu, në këtë poezi,  
ku nga çdo rrokje vjen e çelur ti,  
po ndej dhe pak trishtim, a ndofta mall,  
nga zëri yt i ngrohtë e muzikal,  
ku shprehet dhe një tingull, që s'e thua  
dhe të afron më shumë ty me mua.

Këtu, në këtë poezi,  
ku në çdo fjalë frymë merr dhe ti,  
po mbledh një grusht me çaste, që nuk treten,  
ku si në xham të dy shikojmë veten;  
po mbledh dhe pak ditë... dhe pak natë...  
që ky takim të jetë sa më i bukur,  
që ky takim të jetë sa më i gjatë.

## BRESHËR NË PRILL

Mullarë re mbi nulla dhe uzina,  
sa çiken me mëngore nëpër skela.  
Çaktisin, pa pushuar, vetëtimat  
dhe fiu si erë zhduken harabelat.

Pa në sekondë plot zhurmë e rrëmujë  
errësohet dita, sa dhe rrugët s'njihen.  
Dhe kalimtarët shkasin nëpër ujë,  
dhe ngasin, ku të mundin, që të fshihen.

Ja edhe breshëri!  
Zbardh në gri, si kripë;  
godet me nervozizëm plepa e mana.  
Edhe trimosh, edhe sherrxhi pa cipë:  
qëllon me guralecë mijëra xhamë!

Por vrik ndalon ai, ashtu si nis,  
sa hap e mbyll një derë a një grilë.  
Dhe flladi perdet prapë fillon lëviz  
dhe një këmishë zbardh në tel si krillë.

Dhe del prej reve dita laramanë,  
si bukuroshja që e zë shiu në bahçë.  
Eh, më e këndshme ngjan tani pas banje,  
me ca inxhi prej vese nëpër faqe!

## PRIT DHE PAK

Ja që, mendoj me vete, në jetë ka dhe ndarje,  
tek matem të të them natën e mirë;  
siç ka tërfil e gjemba në luadhe,  
muzikë që të deh e kokëçarje  
dhe yj e antikorpe në hapësirë...

Ja që, mendoj, në jetë ka dhe ndarje.

Ty pulpët vesë e majit po t'i lag,  
tek shkel florinë e hënës nëpër pluhur.  
Nuk di ç'të lidh me hënën atje larg...  
Po kurrë kaq e afërt s'më je dukur,  
kur flet kështu e çiltër: prit dhe pak!

Jo, kurrë kaq e hijshme s'më je dukur.

Dhe unë që ta njoh kaq mirë zënë  
qëndroj dhe të vërej plot gaz në sy.  
E pse vrapon në quell kaq shpejt ti, hënë,  
tani që jemi bashkë ne të dy  
dhe ti një gjysmë fjalo s'na ke thënë?

E pse vrapon në qiell kaq shpjet ti, hënë?

Ne shohim njëri-tjetrin kot, pa folur  
dhe ngeleimi në oborr, pak të hutuar.

Na vëren hardhia e blertë, si të njojur,  
vëren qeni, nga kaçubi, i menduar —

ndonëse asgjë e keqe nuk ka ndodhur.

## TREGIM PËR QENIN TIM TË VOGËL

Kisha në fshatin tim një qen të vogël shok  
dhe duheshim dhe zemëroheshim kot,  
Vraponim nëpër fshat gjithmonë tok.

Kërcenim mur më mur e gardh më gardh —  
ai tre vjet më i vogël, unë tre vjet më i madh —  
e shtriheshim të kënaqur në luadh

dhe misérniken ndanim që të dy.  
Nuk merrja një kafshatë më tepër nga ai:  
Unë e masja me dorë, ai e maste me sy.

Po, kur nuk ndodhej bukë në shtëpi,  
vështronim njëri-tjetrin plot mërsi  
dhe rrnim të tulatur në qetësi.

Dhe teksa vërenim qiellin të mërzitur,  
na shfaqej hëna, si bukë e pa nisur  
(hënën në sofër shpesh e kishim zbritur!)

Dhe e ndanim, që të dy, me drejtësi për darkë  
e hanim dhe e rihanim, prapë e prapë...

Derisa flinim kokë më kokë bashkë.

## DHE NDODH KËSHTU...

Dhe ndodh kështu: vrik qeshim si të marrë,  
kur na mundon një brengë.

Një këngë që ka ikur sjellim pranë,  
shaluar mbi një këngë.

Ne njëri-tjetrit i thërrasim,  
kudo që jemi dhe që vemë.

Dhe në një fronkë rrimë presim  
të zbresë hëna prapë mbi pemë.

Me qindra fije kapërthehen  
si shermashiku nëpër mur.  
Nga Nili prapë shtegtarët kthehen,  
me gjysmëhënën abazhur...

E nga dritaret e kaq viteve  
vërej rrugën nga do vish.  
Dhe prapë në një stacion pritjeje  
ti buzëqesh sërish!

## DHE SHKUMËRIMI I KUQ

Ecim

nën korridorin e pemëve, në rrugë,  
ku asnje gjethe era nuk përpjek,  
(sikur po fle veriu, diku në plep)  
dhe çapemi mbi bar, si të shkelim mbi shkumë.

Ecim!

E na huton, sakaq, metro e gjelbër;  
një zog që na thërret diku nga pema,  
plepat që shtrijnë krahët si të verbër,  
pallatet e tarracat plot antena.

Dhe një mendim prap na cimbith si pincë  
e na degdis, diku, më vite larg:  
E pse peshon kaq fort minuta-grimcë,  
kur çapemi në rrugë të dy bashkë?...

Ecim...

## ME NJË VËSHTRIM

Atë që thotë pisha, kur flladit,  
atë që thotë vesa, kur vesit,  
atë që thotë lulja mbi një gjemb,  
atë që thotë bleta në një gem,  
atë që thotë taka e sandales,  
atë që thotë perla e stërkalës,  
atë që thotë vishnja në buisje  
a nuk ma thua ti me një lëvizje?

Atë që thotë shtërgu që nga plepi,  
atë që thotë vala që rreh deti,  
atë që thotë sythi në një pjergull,  
atë që thotë pylli nëpër mjegull,  
atë që thotë dimrét shelgu i thatë  
atë që thotë breshri në mesnatë,  
  
atë që thotë tingulli i dritës,  
atë që thotë vrapi i muzikës,  
atë që thotë flutura dhe dielli,  
atë që thotë vjeshta dhe peneli,  
atë që thotë flladi nëpër fletë,  
atë që thotë çasti në një jetë,  
atë që thotë moti në stuhi  
me një vështrim  
a nuk ma thua ti?

## DHE SHFAQESH QULLUR KREJT...

Mbi Dajt, pak tinëzisht, një re e murrme bie  
dhe zbrejt një zagushi, përzier tym e hie:  
si me litarë shiu, sakaq, fillon të bjerët it edhe  
dhe dita, si me çelës, errësohet menjëherë.

E më mërzit ky mot. Kërrkund nuk zë dot vend!  
Kur veshi befas kap nga shkallët çapin tënd:  
dhe shfaqesh qullur krejt me ngut në prag të derës  
me çantën mbi një sup e një kordelë ylberesh.

Dhe pikat tërë qejf sajojnë nëpër xame  
ca lepuj të gëzuar, me qyrqe dhe fustane,  
që sa të vërejnë ty kërcejnë hop e qeshin  
dhe gati turren vrap drejt teje të të presin!

Ti i lëmon me gisht e nuk kuptoj ç'u thua.  
Disa zinxhirë vese të shkasin nëpër flokë.  
Ti, ndofta, nuk më do kaq shumë sa të dua  
por prap' sa të takoj, diçka më ther në kockë.

## SA TË KAM THIRRUR

Ndofta të kam qëndruar pak si larg  
edhe padashur të jam dukur si i shthur.  
Dhe ti më ke besuar fare pak...

Sa të kam thirrur!

Ndofta kam biseduar seriozisht me ty.  
Pastaj, papritur, gjuha më është lidhur.  
Dhe ti ke mbledhur supet: Çfarë pati ky?! —

Sa të kam thirrur!

Ndofta kam ardhur me nxitim drejt teje,  
që të të them gjithçka po buza më është dridhur.  
E ti pa zë ke pyetur; E ç'kérkon prej meje? —

Sa të kam thirrur!

Ndofta të jam treguar i çuditshëm  
dhe pa asnjë preteks të kam grindur.  
Ti buzëgaz ke vërejtur e njerëzishme...

Sa tē kam thirrur!

E di! Miliona herë emrin ta kam thënë.

Dhe era tē kish klithur kaq, pēr ty, do tē qe ngji-rur,

Po ti më ke dëgjuar e s'ma ke njojur zënë.

Sa tē kam thirrur!

Ndofta tē kam shkaktuar gaz? Ndofta keqardhje?

«Pse qesh me shpirt, ke thënë, ky?»

«Pse vëren në çast kaq hidhur?»

Në çastin më fatlum e dhimbjen më tē madhe:

Sa tē kam thirrur!

## T I V J E N...

Ti vjen e tjetër tingull ka çdo gjë.

Sikur ndërrojnë ngjyrën sendet.

Sikur ndryshojnë peshën, formën, vendet...

Dhe merr kuptim të ri dhe një brezare drite. që  
papandehur midis nesh u fut,  
edhe një milingonë që rend në mur me ngut,  
dhe një peizazh vendosur sipër radios, kot më kot  
dhe disa rreshta ngelur në blloknot;

dhe një sandale hedhur aty në qoshe, ndofta që  
dy-tre vjet,  
dhe një shëtitje nën shi kur ti diçka më thoshe..

Dhe një balon sa një çadëre i gjerë, që pa u  
nisur mbeti,  
dhe një qyteth që ngritëm në një plazh me rërë,  
tekxa habitej e kënaqej dét!

Dhe një takim që thuajse qe ftohur,  
dhe një rrugicë ku kemi shkelur shumë vite radhë  
dhe nuk e kemi njobur,  
dhe nuk e kemi parë,

ГР НАМ ВИ ПРОТИХИ ОД СЛОВЕНИЈА

Dhe një he objekt... që ish dikur e tani s'di ku  
gjendet.

E ndien? Dička tregojnë, pa na folur, sendet.

Dička papritur zgjohet... dička papritur fle...

Ti vjen... dhe tjetër tingull ka çdo gjë!

## DREJT MEJE DO NXITOSH ME ERËN TI

Ti ecje sipër gjetheve të verdha.  
Kërcisin rrugës fletët.  
I ngrinte gjethet, si rabecka era  
sa desh nuk ciknin retë.

E ndonëse vëreja që çdo hap afroheshe  
të frynte era larg.  
E dridheshin që nën këmbë kuqaloshet  
sikur do merrnin flakë.

Dhe era si e lodhur merrte frymë,  
tek rendte si përherë.  
Dhe kur të thinjen pemët, krejt, nën brymë;  
ti do nxitosh drejt meje tok me erën.

## MBJELLESJA E LULEVE

Pashë një mbjellëse lulesh  
me duar të gërvishtura prej kallove,  
që mbillte lule, plot kujdes, bri trotuareve.

Dhe m'u kujtove ti...

E nuk di pse u zbeha krejt,  
u mjegullua dita e u vërenjt,  
e u drodha që nga maja e kokës gjer te thembra:  
e desha të të shkul nga zemra

dhe mos të të mbjell më askërrkund!

Por, befas, m'u duk se po të të shkulja ty,  
do shkulja edhe të dy sytë e mi  
e do t'u prisja rrënjet gjithë luleve e pemëve:  
mimozave, pishave, blirave e shelgjeve — në  
tërë qytetin tonë.

Dhe do të ngeleshin rrugët e trotuaret  
pa pemë, pa zogj, pa gjethë dhe pa aromë.

Endjeva se ti ishe pema që s'mund të shkuleshe.  
Dhe sytë më shkuan përsëri te mbjellsja e luleve.

## TI JE NJË GRUA E ZAKONSHME

Ti je një grua si të gjitha.  
E, ndofta, në kalim nuk bie hiç në sy.  
Nuk vezullon posi ylber, plot ngjyra e drita  
dhe asnje bli s'kthen kokën pas të të vështrojë ty.

Ti je, siç thonë, një grua e zakonshme,  
që të shkon dita punë dhe shtëpi.  
Por, pse më duket dita kaq e gjatë dhe kaq e lodhshme,  
kur rrugës i mungon një ditë ti?

Ty s'të pëlqen aspak po të të thërras: je flutur!  
Je primabalerina dhe manushaqe prilli!  
Ti s'je, siç thonë, që t'ia heqësh kokën, kaq e bukur,  
dhe se beson të them: ke zë bilbili...

Ti je një grua e zakonshme.  
Po përse ndihem bosh e më rreh zemra shpejt,  
derisa më dhemb,  
edhe më duket ora kaq e gjatë dhe kaq e lodhshme,  
kur nuk dëgjoj një orë zërin tënd?

*IV. Poemata*

OTI

## M Y Z E Q A R E

Nëna shpesh të merrte nëpër ara,  
lije gjurmët baltës gishta-gishta.  
Dridheshe purtekë nga malarja,  
mbi një deng misërishta.

E vështroje si fryhej këneta,  
dyndej uji i verdhë në kasolle:  
e vajtonin dhimbshëm disa plepa  
ngelur tek-e-tuk si karakoje;  
disa kallme... dhe kolona e patave të egra.

Ti prashitje misër.  
Të kujtohet?  
Diç të thoshin bimët e kënaqura prej shatave.  
Të giclonin duke qeshur rrezet.  
Diç tregonte fluturimi i patave...

Ti prashitje misër. Të kujtohet?  
Ndofta dhe këndoje ndonjë këngë?  
Ndofta dhe dremitje pak nën hënë

Mbështetur kokën mbi një çantë-fibër  
(ku diçka ckermit një mi i vogël are),

## ЗНАКОМ

mbështetur kokën mbi një libër,  
mbi një gur a mbi një plis ugari...

Mbështetur kokën mbi një èndërr  
(nga një pikë, thonë, lumi nis!),  
mbështetur kokën mbi një mollë-zemër,  
ku një oqean lëviz.

Ti krijon një pyll të ri hibridë,  
mos ta thajnë ngrica e ciklonë.  
Ti ngulmon t'i bësh Evropës sfidë  
dhe atyre që nuk të besojnë.

Ti nuk mburresh kurrë: shihni ç'jam! —  
për të joshur krushka, krushq e mblesër.  
Ti si luledielli ulur kokën mban  
duke buzëqeshur: shihni nesër!

Nesër...

Dhe shikon ti prapë një luledielli,  
që ndjek diellin pas.

## I H U T H P E R I

Motér, pse s'ia ndan ti sytë qielilit? —  
pyet buzagas.

Dhe shpjegon prapë shkencërisht (pa romantikë) ti  
lidhjet e të shtrenjtit diell me tokën.

Motér, pse me diellin bën shpesh dashuri  
dhe kur shkon ai ti ul menduar kokën?

Kuvendon me fushën e paanë,  
që nuk ka një gardh kërrkund kufi,  
dhe xixëllonjat që të rrinë pranë  
e të bëjnë natën shoqëri.

Ti je myzeqare!

Ti kalon mes erës, kundër rrymës,  
mes kërcejve plot noti të barit.

Ti çapitesh mbi kristalet e brymës  
duke ndier fshikujt e acarit.

Ti mërzitesh duke shkelur në asfalt  
dhe vëren hënën që diku nga mali del.  
Dhe vëren yjet, tek xixëllojnë, që nga lart,  
dhe ndjek patat që gërthasin nëpër qiel.

## I H E S H T U R I

Rri në këtë gur.

Vij në këtë varr të thjeshtë,  
që të flas me ty. Nënë, ti pse hesht?

Vij të rri prapë afër teje, pas kaq kohësh.  
Nënë, pse nuk po më flet një fjalë?  
Ndofta ti nga varri mund të çohesh  
të më mbështetësh dorën pak në ballë.

Ndofta ti dhe hapin ma ke ndier,  
dhe më vëren tek rri mbi këtë gur.

Ti më ke mallkuar qindra herë,  
ke përplasur kokën mur më mur.

Por në këtë luftë kaq të ashpër  
ka dhe dit' të bardha dhe mynxyra.

Ndodh të bie short lëkurë e gjarprit,  
se këtë kostum kërkon detyra...

Nënë, prush e mall kam zemrën plot,  
kaq vjet që s'kemi folur dot.

Para teje jam dhe kalama,  
tek nxitoj ngalodrat, téré lerë,  
edhe burrë, shtatëdhjetë kilo e ca,  
që kuiñtalët peshë mund t'i ngrerë.

Para teje jam dhe zbatharak,  
që të vij me vrap duke çaluar,  
të më heqësh, sa më shpejt, një gjëmb,  
dhe i mpleksur si një rrënëjë gram.

Nënë, diç më dhëmb këtu sot, diç më dhëmb!

\* \* \*

Të kam ardhur plot me vrima plumbi,  
nëpër cifla predhash i copëtar,  
ti ke bërë prapë të pamundurën...  
Ti nga guri i zi ke nxjerrë mjaltë  
dhe më ke shëruar!

Dhe në luftë më ke nisur prapë.

\* \* \*

Ti më ndien nga hapat, kur bëj faj.  
Ti e di kur qesh dhe duke qeshur qaj.

Ti më ke përcjellë shpesh në udhë.  
Ti më deshifron çdo rrudhë.  
Ti e di se ç'flet një dell të më lëvizë.  
Ti më vëren si mikroskop në çdo qelizë:

Mund t'i vidhem plumbit, por jo ty.  
Mund të mos më kapë dot breshëri e sharapnelit.  
Mund t'i vidhem tokës, dëtit, qiellit.  
Mund t'i vidhem priftit jezuit dhe NATO-s.  
Mund t'i vidhem CIA-s, KËGËBË-së dhe  
GESTAPO-s.

Mund të los me cilindo teatër,  
mund të pi shampanjë me një gjarpër,  
mund që të sfidoj sytë magjikë,  
çdo radar dhe mrekulli optike!

Por jo sytë e tu.

Nënë, ti e di kush jam dhe kush kam qenë.  
Ti e di kë vërej në sy dhe kë vërej vëngër.

Ti e di se kë thërras, sa kam fuqi, në èndërr.  
Ti edhe në terr të jem më sheh.  
Ti dhe baltë po të jem më njeh.

Ti e di se si kam rendur, pyll më pyll e mal  
më mal  
dhe jam gdhirë midis akujsh:  
në Gramos, Nermëçkë dhe Shupal...

Ti e di si zgjoheshim nga alarmet,  
si na vranë, që nga ferrat, bandat  
Bardhok Bibën, Llazin, Palin.

Ti e di se si jam turrur shpesh për jetë a vdekje  
duke fshehur çdo vullkan në heshtje,  
Dhe jam ndeshur përsëri me «shokët»,  
në çdo befasë me thonj e dhëmbë,  
me qivurin, gati, përmbi kokë

dhe kam ngelur, përsëri, në këmbë!  
Nënë, vij të kuvendoj me ty:

kaq vjet që s'po tē shoh me sy!

Vij tē them se lufta eshtë e vështirë  
(ndeshja tmerrësisht e egër!).

Qenka zor tē ngelesh gjer në fund i mirë,  
pa tē ngrirë akulli në zemër.

Dhe tē dalësh qindra herë që nga balta,  
në çdo ndeshje tē pabarabartë,  
dhe tē ngelen duart po tē pastra,  
dhe ta mbash mes njerëzve kokën lart!

Vij në gëzof prej mjegulle mbështjellë  
dhe plot kërshëri nga larg më shohin.  
As më kanë parë dhe as më njohin  
dhe çuditën, ndofta, qytetarët:  
kush po flet me nënën e tradhtarit?! —

Nënë, shumë vite je përpjekur,  
duke ulur sytë puq me tokën.

Ndofta dhe në varr kështu e vdekur  
rreh me grusht pareshtur prapë kokën.

Nënë, erdha prapë te ty si erë,  
më dëgjo, tē lutem, dhe një herë.

## QHTONE LAYMET E LUNDIT

Po t'i them, t'i dish këto tre fjalë,  
që t'i mbajta fshehur kaq vjet!

Ndofta ty aky lajm mund të të ngjallë?

Ty, që nga hidhërimi dheu s'të tret  
e do brofësh prapë tërë hir:

— S'e harrove nënën tënde, bir! —

E do të krenohesh ti me mua  
siç krenohem unë shpesh me ty.

— Shihni ç'djalë kam! — me gaz të thuash, —  
duke qeshur prapë me lot në sy.

Ta dëgjojnë këtë lajm të mirë,  
tok me ty, të vdekur e të gjallë.

Dhe të çelen prej drithërimit lulet,  
dhe të çahen prej gëzimit gurët,  
dhe të dridhen prej gëzimit malet:

Nënë, nuk të kam tradhtuar kurrë!

Nënë, nuk të kam harruar kurrë!

## Ç'THÔNË LAJMET E FUNDIT

Ka ditë që s'i dëgjoj dot lajmet.  
nuk mund të vërej një çast televizorin.  
E nuk guxoj as t'i afrohem radios!

Lëviz butonin e s'e lëviz dot.

Lëviz butonin e ndiej një zbrazëtirë  
e stërmundim të jashtëzakonshëm.  
Më lodh kjo pritje e vështirë...

Lëviz butonin e s'e lëviz dot.

Sikur të rrrotulloj hënën e mokrës.  
Sikur vërtit cilindrat metalikë në uzinë.  
Sikur të vërtit aksin gjigant të tokës!

Po bëhem për një çast dhe unë si Tezeu,  
q'ë kish dënuar Zeusi idhnak të mbante globin  
përmbi supe,  
që të mos binte!

Lëviz butonin...

Jo! Asnjëherë lajmet s'kanë pasur forma kaq konkrete.

Nuk kanë pasur një kundërmim të gjallë, kaq pikant.

Nuk kanë qenë kaq gjeometrike: copëza matri, popla dhe figura.

Kaç tronditëse!

C'thonë lajmet e fundit?

Lajme që bëjnë të të piqet në sekondë buza përflakur nga gjaku i trimave.

Lajme që të djegin, si shpuza fytyrën.

Që dalin nga dritaret e godinave në flakë.

Lajme të kobshme e të përdëllyera!

Shembëlltyra të fëmijëve, që shtrijnë krahët e drithëruar drejt botës dhe bota i shikon e hesht.

Bota e qytetëruar i shikon e hesht!

Lajme që bien erë shkrumb, tek tundin gjymtyrët e shqyera të njerëzve.

Shembëlltyra të flokëve të lëshuara të një néné,  
si tymnajë kamine,  
që thërret botën pér ndihmë.  
**D**he bota e shikon e hesht!

Bota e qytetëruar,  
që di aq bukur të mallkojë e të ngjiret,  
sa nga shqetësimi i madh i është prerë krejt  
ka pesë vjet që ulërin e cirret:  
pér një kopuk, sekser katolik, të quajtur Les  
oreksi;  
Valensi!

C'thonë lajmet e fundit?

Lajme: përbindsha të shëmtuar, të posadalë nga  
protoplazma,  
që tundin mbi kokën e botës, si shpatë Demo-  
kleu,  
kryqin e thyer.

Lajme: vizione, hije e fantazma,  
që të ndihesh deri në palcë i fyter!

Bejrut. Janë prerë furnizimet me ujë, barna dhe  
ushqime.

U mbyll aeroporti ndërkombëtar.  
Janë prerë që të gjitha lidhjet...

Bejrut. Pesëdhjetë herë sulmuan tanket izrae-  
lite  
pozicionet palestinezë, brenda pesë ditëve,  
dhe pesëdhjetë herë tanket u thyen!

Lajme të përgjakshme, me plagë të panumërtë,  
që vijnë nga katakombet e blindazhet në zjarr.  
Dhe kërkojnë për të plagosurit kokainë dhe  
bandazhe.  
Dhe lypin urgjent një pikë ujë për të eturit  
(ata mund të pijnë krejt edhe detin nga etja!),  
një çyrek bukë për të uriturit,  
një shishe qumësh për të miturit!

Dhe bota i dëgjon e hesht  
ose bën sikur nuk ka dëgjuar.

Bota e qytetëruar,  
që pret me ankth nga një orë në tjetër  
për të lexuar buletinet mjekësore  
mbi gjendjen shëndetësore të papës Vojtila,  
pas plagosjes «monstruze» në Shën Pjetër!

## C'thonë lajmet e fundit?

Lajme që të mburresh pse je njeri  
dhe të të vijë turp pse je njeri.

Lajme për konstruksione ligjesh e qytetesh,  
ngritur gjatë mijëra vjetësh prej gjeneratave,  
që grihen çikë-çikë nën makinacionet e kuli-  
seve diplomatikë  
dhe nën zinxhirët e tankeve!

Bejrut. 500 herë sulmuani me bomba avionët  
izraelitë,  
brenda dhjetë ditëve, lagjen palestinezë  
dhe nuk e shembën!

Lajme që flasin për fëmijë të mitur,  
të cilët rriten papritur  
të marrin hak për vëllezërit e për prindërit.

Lajme që reklamojnë forcën shkatërrimtare të  
raketave, minave e bombave,  
për tregtinë e armëve

dhe qëndresën e nxënësve dhe grave,  
mes gërmadhave dhe katakombeve!

Lajme, copëza ndërtesa të shkrumbuara.  
Kufoma foshnjesh e grash, ngelur rrugëve:  
të mbuluara e të zbuluara nga rrënojat.  
Lajme që fluturojnë si barela, me të plagosur e me  
të vrarë, në të gjitha anët e globit  
duke thirrur:

— Ja vrasësit! —

Dhe bota i shikon e hesht  
Ose bën sikur nuk i ka shikuar...

Bota e qytetëruar,  
që desh u çmend e u «rrënuar» krejt  
nga karnavalet: Çështja Uotergejt!

Lajme me Filip Habib e Gromiko.  
Lajme që të rëqethin mishtë.  
Dhe që të bëjnë të ndiesh turp pse je njeri  
dhe të krenohesh pse je njeri!

Lajme që flasin për forcën shkatërrimtare të armëve  
dhe pavdekësinë e një populli.

Lajme që kërkojnë një kopsht.., një vatër.., dy pashë  
varr...

Për një popull heroik. Të pamposhtur. Pesëmijëvjeçar.

Lëviz butonin e s'e lëviz dot.

Dhe mallkoj dimensionet e objekteve gjeografike  
dhe tërë shpikjet burokratike që ka bota:  
postblloqe, xhandarë e pasaporta!

Dhe mallkoj mjetet e transportit,  
edhe tani në epokën e shpejtësive kozmike,  
që nuk më ndihmojnë dot!

E më vjen të pëlcas,  
që s'mund të bëhem dot erë  
dhe nuk jam mbret përralle, që të thaj detin  
e të vij, menjëherë, aty ku më prisni!

Lëviz butonin e s'e lëviz dot.

## PËRMBAJTJA

### I. POEZITË E DITËS

|   |    |
|---|----|
| Nxitoj .....                                      | 5  |
| Në fshat .....                                    | 7  |
| Poezi për të thjeshtin .....                      | 9  |
| Pritja .....                                      | 11 |
| Lëvizje .....                                     | 13 |
| Gjyshi .....                                      | 14 |
| Shi behari .....                                  | 16 |
| Turnet .....                                      | 18 |
| Urim për Vitin e Ri 1986 .....                    | 20 |
| Mësuese .....                                     | 22 |
| Midis turnit .....                                | 24 |
| Vargje për time bijë .....                        | 26 |
| Poezi për targat dhe tim nip, polic trafiku ..... | 28 |
| Ra ora .....                                      | 30 |
| Se dua të mendoj që jam vërtetë në fshat .....    | 33 |
| Shi në gusht .....                                | 35 |
| Ku shkon .....                                    | 36 |
| Kërrkund nuk jemi vetëm .....                     | 38 |
| Ikja nga shtëpia «Niko Belojanis» Durrës .....    | 40 |
| Pse hovët gjer këtu .....                         | 42 |
| Tek po çel e para ditë e verës .....              | 43 |

|                                |    |
|--------------------------------|----|
| Armiku i klasës .....          | 45 |
| Baladë për ujin e bekuar ..... | 47 |
| Horizonte .....                | 49 |

## II. POEZITË E LUFTËS

|                           |    |
|---------------------------|----|
| Në rrugë... .....         | 55 |
| Nëna Sibe .....           | 57 |
| Prifti .....              | 58 |
| Elena .....               | 60 |
| Tanku .....               | 62 |
| Dashuri .....             | 64 |
| Lola .....                | 66 |
| Ramiz Varvarica .....     | 68 |
| Petro Nini Luarasit ..... | 71 |
| Sef Kosharja .....        | 73 |

## III. DITARI LIRIK

|   |    |
|---|----|
| Rrjedh një përrua .....                   | 77 |
| Ti .....                                  | 79 |
| Deti .....                                | 80 |
| Lirikë .....                              | 81 |
| Breshër në prill .....                    | 82 |
| Prit dhe pak .....                        | 83 |
| Tregim për qenin tim të vogël .....       | 85 |
| Dhe ndodh kështu... .....                 | 86 |
| Ecim .....                                | 87 |
| Me një vështrim .....                     | 88 |
| Dhe shfaqesh qullur krejt... .....        | 89 |
| Sa të kam thirrur .....                   | 90 |
| Ti vjen... .....                          | 92 |
| Drejt mëje do të nxitosh me erën ti ..... | 94 |

|                                  |    |
|----------------------------------|----|
| Mbjellësja e luleve .....        | 95 |
| Ti je një grua e zakonshme ..... | 96 |

#### IV. POEMAT

|                               |     |
|-------------------------------|-----|
| Myzeqare .....                | 99  |
| I heshturi .....              | 102 |
| C'thonë lajmet e fundit ..... | 108 |